

VENDIM
Nr. 99, datë 9.5.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DUFERCO SHQIPËRIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/3 prot., datë 5.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Duferco Shqipëria’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 55, datë 29.3.2022, vendosi të mosfillojë procedurën, për licencimin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, shoqëria, me shkresat e datës 28.4.2022, protokolluar në ERE me nr. 314/3, datë 28.4.2022 dhe nr. 314/4 prot., datë 29.4.2022, ka depozituar dokumentacionin përkatës për këtë aplikim dhe dokumentacioni i paraqitur më herët konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin si më poshtë:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, plotësuar;
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;
- Dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti